



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. 520/2 Prot.

Tiranë, më 16 / 04 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 54, Datë 16 / 04 / 2019**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, mori në shqyrtim ankesën me nr.33, datë 02.04.2019, të S. S, kundër: Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciale (DAPSHET), me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak “*të bindjeve politike*<sup>2</sup>”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

S. S prej 16 vitesh ka qenë në marrëdhënie pune<sup>4</sup> me FSDKSH dhe DAPSHET, në detyra të ndryshme, duke specifikuar si më poshtë:

- Nga data 23.09.2002-31.05.2004 ka qenë e emëruar në pozicionin “Specialiste ekonomiste” në Sektorin Ekonomiko-Financiar, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Referuar Vërtetimit lëshuar nga Dega nr.4 e Partisë Demokratike të Shqipërisë, datë 28.03.2019, citohet se: “Vërtetohet se ankesja është aktiviste e e Lidhjes Demokratike të Gruas në këtë Degë dhe mbesë e të ndjerit Azem Hajdari, Pishtar i Demokracisë”.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>4</sup> Ndërkaq citon se ka një vjetërsi pune prej 34 vitesh me insitucionet publike të RSH.

- Nga data 01.06.2004-31.03.2006 ka qenë e emëruar në pozicionin “Specialiste ekonomiste/kontrolli ekonomik-financiar” pranë Drejtorisë Qendrore të FSDKSH Tiranë.
- Nga data 01.04.2006-24.03.2014 ka qenë e emëruar si “Përgjegjëse” në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në FSDKSH. (Çertifikuar si Audituese në vitin 2008).
- Më pas, ankuesja shprehet se pasi është larguar, pa dëshirën e saj nga ky pozicion, për një vit ka punuar në Drejtorinë e Kontrollit Spitalor (pa specifikuar pozicionin).
- Për tre vitet e tjera pasardhëse ka punuar si “Specialiste kontrolli” në Sektorin e Kontrollit Ekonomiko-Financiar, sot m emërimin DAPSHET.
- Ndërkaq, nëpërmjet Urdhërit nr.38, me shkresën me nr.378/2 prot., datë 25.05.2018 i është zgjidhur kontrata e punës.

Ndodhur në këtë situatë, subjekti ankues ka ngritur pretendimin se largimi i saj nga puna nuk ka ardhur për arsye të ligjshme dhe të justifikuara, por për shkak të bindjeve të saj politike, si aktiviste e Lidhjes Demokratike të Gruas/Partia Demokratike dhe si mbesa e Dëshmorit të Demokracisë, Azem Hajdari. Ajo ka shprehur bindjen se punëdhënësi e ka diskriminuar atë, përmes largimit nga puna, pikërisht për shkak të bindjeve të saj politike, dhe të lidhjes së saj familjare, si mbesë e të ndjerit, Azem Hajdari; duke fshehur shkakun e vërtetë përmes justifikimit të ristrukturimit të institucionit.

Në përfundim të ankesës, S. S kërkon nga Komisioneri:

- Të konstatojë diskriminimin e saj nga ana e punëdhënësit dhe të ndërmjetësojë për rikthimin e saj në punë.
- Të gjobisë subjektet FSDKSH dhe DATSHET për shkelje të LMD.
- Të detyrojë subjektet FSDKSH dhe DATSHET ta dëmshpërblejë atë në shumën 7.440.000 lekë për diskriminimin e shkaktuar ndaj tij.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin

*I të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve, emërimeve të ankueses, dhe pretendimit për largimin e saj nga puna, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se ajo ankohet kundër dy subjekteve: FSDKSH dhe DAPSHET, ankesa në thelb duhet drejtuar kundër DAPSHET, në cilësinë e punëdhënësit të saj të fundit.

Mbështetur në kopjen e Kërkesë-Padisë<sup>5</sup> së depozituar pranë KMD-së, bashkëlidhur ankesës, rezulton se subjekti ankues, pretendimin e saj për diskriminim nga ana e punëdhënësit e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjatë arsyetimit të kërkesë padisë së bërë nga ankuesja pranë Gjykatës e Shkallës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në faqen 6 (gjashtë) të saj, citohet se: *“I padituri DAPSHET, duke më larguar nga puna, ka shkelur nenin 9 “Ndalimin e diskriminimit”, pikën 2, sepse ka bërë dallim midis meje dhe punonjësve të tjerë që ka mbajtur në punë, nisur nga bindjet e mija politike dhe përkatësisë sime familjare, si mbesa e ish-liderit të parë të demokracisë shqiptare, Heroit të Demokracisë z.Azem Hajdari”.*

Ankuesja ka ngritur pretendimin se është shkelur dhe LMD, duke cituar konkretisht, nenin 3 “Përkufizime”, nenin 5 “Ndalimi i diskriminimit”, nenin 7 “Mbrojtja nga diskriminimi”, nenin 12, pikën 1 “Mbrojtja nga diskriminimi në punësim”, nenin 13 “Detyrimet e punëdhënësit për ndalimin e diskriminimit”.

Në faqen 2 dhe 7 të kërkesë padisë, subjekti ankues, pretendon cënim të nenit 18<sup>6</sup> të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 146, të Kodit të Punës, dhe respektivisht të pikës 1/c) të tij, ku parashikohet se zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: *“c) bëhet për motive të pandashme nga personaliteti i punëmarrësit, por që nuk kanë lidhje legjitime me raportet e punës. Konsiderohen si motive të tilla, raca, ngjyra, seksi, mosha, gjendja civile, detyrimet familjare, shtatzania, besimi fetar, bindjet politike, kombësia, gjendja shoqërore”.*

<sup>5</sup> Kërkesë Padi e depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 01.10.2018.

<sup>6</sup> *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”.*

Bazuar në sa më sipër, S. S, në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pretenduar trajtimin e disfavorshëm dhe diskriminues nga ana e punëdhënsit, për shkak të bindjeve politike dhe të lidhjeve familjare me Azem Hajdarin, si mbesë e tij.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: “...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr.33 Regj., datë 02.04.2019, të S. S, kundër punëdhënsit, DAPSHET.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.**

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36, pika 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **VENDOSI:**

- 1.** Mospranimin e ankesës nr. 33 Regj., datë 02.04.2019, të S. S, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku : Bindjet politike. Lidhjet familjare

Fusha: Punësim